

29.12.2018

C.nr.213/18

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu dhe bashkëpunatoren profesionale Fitore Hasani-Ismaili, në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rr. [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] të cilin me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR] avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim [REDAKTUAR] në çështjen juridike për pagesë e pagave përcjellëse dhe jubilarë, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij, si dhe të përfaqësuesit të të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me datë 31.10.2018, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rr. [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR].

**II.DETYROHET** e paditura Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej **1.526.80 €**, (një mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë euro e tetëdhjetë cent), të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatën në lartësi prej 8%, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe të paguaj shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej **269.20 €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

### **A r s y e t i m i**

Paditësi [REDAKTUAR] nga Ferizaj, rr. [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] përmes përfaqësuesit të tij avokat [REDAKTUAR] avokat nga Ferizaj, me datë 13.03.2018, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

I autorizuarit i paditësit në seancën e mbajtur ka thekësuar se mbetem në tërësi pranë thekësimeve në padi i propozoj gjykatës që të administrohen si prova vendimi nr.716, i datës 31.10.2017, kontrata e punës e datës 01.03.2015, vërtetimi i lëshuar nga SH.M.E "Faik Konica" në Ferizaj i dt.18.10.2017, fotokopja e librezës së punës, regjistri i pagave mujore nga BRK dhe pasqyra bankare e NLB, i propozojmë gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar

I autorizuari i të paditurës në përgjigjeje në padi të datës 20.07.2018 dhe në seancën e datës 31.10.2018, ka deklaruar se mbetet në tërësi si në përgjigjen në padi duke kontestuar kërkesë padinë e paditësit sepse nga provat që në dosjen e lëndës konstatojm se paditësi ka shkuar në pension me datë 19.10.2017, e sa i perket kërkesës për pagë jubilarë konstatojm se në kuptim të nenit 35 të kontratës kolektive të arsimit dhe SBASHK-ut e datës 18.04.2017 del se pagesa jubilarë i paguhet puntorve të cilët janë të punësuar me rastin e 7 marsit të çdo viti kurse paditësi është pensionuar me dt.19.10.2017 dhe nga momenti i pensionimit ai nuk ka mundur ta realizoj shpërblimin jubilar kurse kontrata e dt.18.04.2017 nuk mund të aplikohet për datën 07.03.2017e cila nuk ka karakter retroaktiv, sepse një gjë e tillë nuk është paraparë me kontratën kolektive, e cila ka parapar shprehimisht se e njëjta hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese. Nuk e kontestojm se paditësi ka 30 vjet përvoj pune.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes kontestimore, për aq sa palët ndërgjygjëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, gjykata ka administruar provat si vijojnë: *vendimi me nr.716 i datës 31.10.2017 mbi ndërprerjen e marrdhënies së punës, kontrata e punës me nr.61 e datës 01.03.2015, vërtetimi i lëshuar nga SH.M.E "Faik Konica" në Ferizaj me nr.510, fotokopja e librezës së punës me nr.237/83, përgjigja në kërkesë me nr.755 e dt.22.11.2017, lista e pagavepër muajin gusht, shtator dhe tetor të vitit 2017, gjendja e llogaris së paditësit nga data 01.01.2017 deri 31.12.2017, regjistri i pagesave të pagave i datës 05.03.2018*

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditësit se ka përvojën e punës mbi 7 vjet në arsim.

Me leximin e Kontratës së punës me nr. Protokolli: 61 e datës 01.03.2015, Gjykata ka konstatuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie punë tek e paditura deri në momentin e pensionimit me datë 01.11.2017. Me leximin e vendimit për ndërprerjen e marrdhënjes së punës nr.716, të datës 31.10.2017, gjykata ka konstatuar se paditësit ju është ndërprerë marrdhënja e punës me arritjen e moshës së pensionimit, me leximin e shkresës zyrtare nr.755, të datës 22.11.2017, gjykata ka konstatuar se paditësit ju është refuzuar kërkesa për kompensimin e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, me leximin e listave të pagave për muajt, gusht,

shtator dhe tetor, gjykata ka konstatuar se paditësi në tre muajt e fundit ka realizuar mesatare e pagës në shumë prej 508.94 €.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontrate për faktin se me rastin e daljes së saj në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Kurse neni 35 par. 9 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë 508.94 € dhe nuk ka pas ndonjë ndryshim në tre muajt e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes është bazuar në këtë fakt se meqenëse nuk ka pasur ndryshime në pagat që të merret një mesatare e ka marr për bazë tri pagat e fundit që ka ndodh në rastin konkret rezulton se paditësi ka pasur pagën mujore tek e paditura shumë prej 508.94 €.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t'ia kompensoj shumë prej 269.20 €, për përpilim të padisë shumë prej 104.00 €, për një seanca të mbajtur shumë prej:135.20 €, dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 30.00 €.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA E KOSOVËS  
**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**

**C.nr.213/18 date 31.10.2018**

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më Dana 09.01 2019

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate

